

Europa: Një Komunitet Vlerash



Është shumë e rëndësishme për çdo banor dhe qytetar të Bashkimit Europian (B.E.) të njohë vlerat mbi të cilat bazohet sot B.E. Ky informacion ofron tek secili nga ne që banon në një nga vendet e B.E. mundësinë e njohjes dhe të përdorimit të të drejtave që i afrojnë Bashkimi Europian dhe të përzgjedhë llojin e Europës që dëshiron të mbështesë.

Bashkimi Europian, në të cilin Greqia bën pjesë që nga viti 1981, nuk ka patur gjithmonë formën e sotme. Bashkimi Europian u ndërtua gradualisht gjatë pesëdhjetë viteve të fundit nëpërmjet pesë zgjerimeve të cilat e pasuruan identitetin e tij dhe krijuan fizionominë e sotme. Paralelisht, një seri Traktatesh riqartësuan se cilat vlera karakterizojnë B.E. dhe cilat të drejta të njeriut gjenden në epiqendër të veprimtarisë së tij.

Në këtë broshurë prezantojmë shkurtimisht vlerat e përbashkëta të B.E. dhe rolin e tyre në formimin e politikave dhe veprimtarive Europiane. Shpresojmë të përbëjë një burim të rëndësishëm informacioni, por edhe një bazë për një dialog të metejshëm në lidhje me të ardhmen e zgjerimit të Europës të 25-ëve dhe së shpejti të 27-tëve, 28-tëve ose dhe më shumë shteteve anëtare.



Harta e B.E. e 25 vendeve anëtare e 2006



Burimi: Europa në zhvillim

1957	Komuniteti Ekonomik Europian (KEE) përbëhet nga Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda.
1973	Integrohen Danimarka, Britania e Madhe dhe Irlanda.
1979	Realizohen zgjedhjet e para për Parlamentin Europian.
1981	Integrimi i Greqisë
1985	Akti i Vetëm Europian ka si qëllim krijimin e tregut të vetëm
1986	Me integrimin e Spanjës dhe të Portugalisë Komuniteti Ekonomik Europian numëron dymbëdhjetë anëtarë.
1990	Ribashkimi i Gjermanisë
1992	Traktati i Maastricht i ndryshon emrin nga Komunitet Europian në Bashkim Europian dhe përcakton kriteret për krijimin e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar dhe, si rrjedhojë, monedhën euro.
1995	B.E. zgjerohet duke përfshirë Austrinë, Finlandën dhe Suedinë
1999	Hyn në qarkullim Monedha Euro
2004	Realizohet zgjerimi më i madh i B.E. me hyrjen e 10 shteteve të reja. Sot B.E. e 25-tëve përfshin edhe Estoninë, Qipron, Letoninë, Lituani, Maltën, Hungarinë, Poloninë, Çekinë, Slovakinë dhe Slloveninë

Vlerat e Bashkimit Europian

Bashkimi Europian nuk kufizohet vetëm në funksionimin e një tregu të vetëm me një politikë të përbashkët të tregtisë së jashtme dhe një monedhë të përbashkët. Qëllimi kryesor i procedurës së integritimit Europian është sigurimi i një shoqërie të së drejtës dhe të sigurisë e cila do të promovojë paqen dhe stabilitetin jo vetëm në Europë por në mbarë botën.

Shtetet anëtare kanë deklaruar se Bashkimi Europian është një familje e vendeve demokratike me një të kaluar të përbashkët kulturore dhe historike, e cila bazohet në vlerat ekumenike botërore:

Liria
Respektimi i të Drejtave të Njeriut
Barazia
Shteti i së Drejtës
Demokracia
Siguria
Drejtësia

(Traktati i Bashkimit Europian, Maastricht, 1992).

Që nga viti 1992, shtetet anëtare të B.E. kanë marrë përsipër të punojnë së bashku për paqen dhe prosperitetin e popujve të tyre dhe të promovojnë demokracinë dhe vlerat europiane në marrëdhëniet e tyre të jashtme si dhe në politikën e përbashkët të jashtme të B.E.. Mbështesin, gjithashtu, natyrën e pandarë dhe të ndërvarur të vlerave të përbashkëta të B.E. të nevojshme për stabilitetin ndërkombëtar dhe rajonal, sigurinë dhe prosperitetin.

Bashkimi Europian synon të zbatojë këto vlera nëpërmjet veprimtarisë së tij si në nivel të brendshëm, domethënë në 25 shtetet anëtare, ashtu dhe në vendet që janë gati të anëtarësohen, si edhe në vendet që dëshirojnë anëtarësimin në B.E., si p.sh. vendet e Ballkanit Perëndimor.

Veprimtaria e B.E. nuk kufizohet vetëm në hapësirën gjeografike të zgjeruar të saj, por shtrihet dhe në pjesën tjetër të botës nëpërmjet bashkëpunimit zhvillues, ndihmës ekonomike dhe teknike, programeve mbështetëse, tregtisë dhe dialogut politik si në nivel dypalësh ashtu edhe në kuadrin e organizmave ndërkombëtare dhe rajonale (si OKB, NATO, OBT).

Por para së gjithash B.E. deklaron se procedura e integritimit Europian afron avantazhe dhe krijon kushtet e përshtatshme për zbatimin maksimal të vlerave të lirisë, dinjitetit njerëzor dhe prosperitetit të individit tek qytetarët dhe banorët e shteteve anëtare të tij. Arritja e këtyre qëllimeve promovohet nga:

- Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të qytetarëve europianë të përmbledhura në një tekst të përbashkët
- Institucionalizimi i nënshtetësisë Europiane dhe i të drejtave që burojnë nga ajo
- Krijimi i një hapësire të vetme lirie, sigurie dhe drejtësie nga i cili mund të përfitojnë plotësisht të gjithë ata që jetojnë në çdo vend të Bashkimit Europian.

Nënshtetësia Europiane

Nënshtetësia e B.E. përbën kusht për nënshtetësinë e qytetarit në një nga shtetet anëtare. Kështu, çdo individ i cili është qytetar i një shteti anëtar konsiderohet qytetar i B.E.. Institucionalizimi i konceptit të nënshtetësisë të B.E. nuk zëvendëson nënshtetësitë e shteteve anëtare, thjesht i shtohet atyre, pra është plotësues.

Nënshtetësia e B.E. njeh katër të drejta speciale:

- qarkullimin e lirë dhe banimin në të gjithë territorin e B.E.
- Zhvlerësimi i kufijve të brendshëm lehtëson lëvizjen e lire të qytetarëve që respektojnë ligjin në të gjithë Europën. Traktati Schengen futi masa për mbrojtjen e kufijve dhe promovon bashkëpunimin midis forcave policore kombëtare dhe organeve gjyqësore me qëllim që lëvizja e lire të mos kthehet në objekt shfrytëzimi nga kriminelë dhe terroristë.

Zona «SCHENGEN» përbëhet nga 15 shtete anëtare: Greqia, Austria, Belgjika, Franca, Gjermania, Luksemburgu, Holanda, Danimarka, Italia, Spanja, Portugalia, Finlanda, Suedia, Norvegjia dhe Islanda.

Britania e Madhe dhe Irlanda nuk zbatojnë rregullat e Traktatit Schengen, pa prekur kjo të drejtat e qytetarëve të B.E. të hyjnë dhe të jetojnë në këto vende.

Pritet adoptimi nga Zvicra në 2008 dhe gradualisht nga shtete e reja anëtare të B.E.

- e drejta e votimit dhe për t'u votuar në zgjedhjet lokale dhe në zgjedhjet e Parlamentit Europian në shtetin e banimit
- në rast se një qytetar Europian ndodhet në një vend jashtë B.E. në të cilin vendi i tij nuk ka përfaqësi diplomatike, mund të kërkojë mbrojtjen diplomatike dhe konsullore nga organet e një shteti tjetër anëtar të B.E.
- e drejta e referimit dhe e apelit tek Ombudsman-i Europian.

Ombudsman-i Europian shqyrton denoncimet ndaj organeve dhe organizmave europianë në rastet e vonesës së pajustificueshme, refuzimit të dhënies së informacionit, diskriminimit dhe shpërdorimit të pushtetit. Denoncimet mund të kryhen nga qytetarët europian por edhe nga të gjithë ata që jetojnë në shtetet anëtare të B.E., si edhe nga kompani ose organizata të cilat kanë selitë e tyre në B.E..



Qytetarët e B.E.

Të gjitha vlerat themelore të B.E. të përmbledhura në një tekst

Vlerat europiane njihen nga Karta e të Drejtave Themelore të B.E. e cila u nënshkrua nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të B.E. në vitin 2000. Në kartë janë përmbledhur në një tekst të gjitha të drejtat e qytetarëve Europian të cilat deri në atë kohë ndodheshin të shpërndara në akte të ndryshme ligjore.

Në hyrjen e Kartës së të Drejtave Themelore, referohet se:

«Popujt e Europës, duke themeluar midis tyre një bashkim të ngushtë në vazhdimësi, vendosën të ndajnë një të ardhme paqësore të bazuar në vlera të përbashkëta

Bashkimi Europian, duke marrë parasysh trashëgiminë shpirtërore dhe morale të tij, bazohet në vlerat e pandara dhe ekumenike të dinjitetit të njeriut, të lirisë, të barazisë dhe të solidaritetit dhe mbështet principet e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës. B.E. e vendos njeriun në zemrën e veprimtarisë së tij, duke themeluar nënshtetësinë e B.E. dhe duke krijuar një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie»

Karta bazohet tek të drejtat dhe liritë e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit Europian (1950) e cila zbatohet tashmë në 46 vende Europiane. Për më tepër, Konventa adopton një gjuhë dhe një qëndrim më koherent ndaj shumë lirive dhe të drejtave duke reflektuar kështu zhvillimet në kornizat ligjore kombëtare të shteteve anëtare.



Burimi: www.europarl.eu.int

Banorët e B.E.

Pesëdhjetëvjeçarin e fundit, Bashkimi European ka krijuar për qytetarët e tij predispozitat bazë të një hapësire të përbashkët prosperiteti dhe paqeje, që i lejon të gëzojnë në një nivel të kënaqshëm të mirat bazë të lirisë, të drejtësisë dhe të sigurisë. Gjithsesi, këto të mira nuk përbëjnë të drejtë ekskluzive vetëm të qytetarëve të B.E.

Bashkimi European përbën një pol tërheqës për shumë burra dhe gra nga vende të treta. Ata arrijnë në kufijtë e shteteve anëtarë në kërkim të punës, ose thjesht për një jetë më të mirë e cila nuk i ofrohet në vendin e origjinës.

Sot, ekzistojnë më shumë se 175 milionë emigrantë në mbarë botën. Pothuajse, 56 milionë banojnë në Europë.

Një nga vlerat e B.E. është dhe lufta kundër të gjitha formave të diskriminit, racizmit dhe ksenofobisë. Bashkimi European mundohet t'i përballi këto fenomene me masa ligjore, ekonomike dhe sociale të cilat synojnë në luftën kundër marxhinalizimit dhe përjashtimit social të popullatës së huaj me banim në 25 shtetet anëtare të tij.

Nën këtë objektiv dhe në kuadrin e politikës së përbashkët të emigracionit, Këshilli European në Tampere (1999) hodhi bazat e një kornize legjislative të përbashkët. Qëllimi i kësaj kornize legjislative është siguri i trajtimit të barabartë dhe të drejtë të të gjithë të huajve me qëndrim të ligjshëm në territorin e shteteve anëtare të B.E. duke i dhënë atyre sa më shumë të drejta, të ngjashme me të drejtat e qytetarëve European, meqënëse sukcesi i kohezionit social në mbarë Europën dikton integrimin social, politik dhe ekonomik të emigrantëve me qëndrim të ligjshëm në shtetet anëtare.


Të drejtat e të gjithë atyre që banojnë brenda B.E përfshijnë të drejtën e qëndrimit, të arsimimit, të punës së varur ose të pavarur, të drejtën e qarkullimit të lirë për një afat të shkurtër kohor brenda kufijve të B.E. si edhe të drejtën e trajtimit të barabartë. Gjithashtu, korniza e përbashkët ligjore parashikon:

- ata që kërkojnë azil të gëzojnë trajtim të drejtë
- emigrantët e ligjshëm të integrohen në shoqëritë europiane dhe të gëzojnë të drejtën e drejtësisë dhe të sigurisë,
- kur qëndrimi i emigrantëve është shumëvjeçar, t'ju jepet mundësia e marrjes së nënshtetësisë të shtetit anëtar në të cilin banojnë, dhe si rrjedhojë edhe të nënshtetësisë europiane.
- të merren masat e nevojshme për ruajtjen efektive të kufijve të jashtëm, dhe përballimin e emigracionit klandestin, duke ofruar paralelisht mbrojtjen e mjaftueshme viktimave të trafikut klandestin.

Vitet e fundit Bashkimi European ka bërë hapa të rëndësishëm për zbatimin dhe konsolidimin e vlerave që përfaqëson si brenda B.E. ashtu dhe në marrëdhëniet e jashtme të tij. Përpjekjet nuk kufizohen vetëm në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe banorëve të tij, por edhe në promovimin e të drejtave të njeriut në vendet me të cilat bashkëpunon dhe ka marrëdhënie tregtare.

Por, implementimi i këtyre objektivave të B.E. ndesh vështirësi si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë lokal dhe rajonal dhe padyshim ekziston mundësia e përmirësimit të tyre.

Një paraqitje e përmbledhur e të Drejtave tona Themelore



DINJITETI

E Drejta e Dinjitetit dhe e Jetës
E Drejta e Integritetit të Njeriut
Ndalimi i Torturave & i Ndëshkimeve ose i Trajtimeve
Çnjerëzore dhe Poshtëruese
Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar

LIRIA

E Drejta e Lirisë dhe e Sigurisë
Respektimi i Jetës Private dhe Familjare
Mbrotjtja e të Dhënave të Karakterit Personal
E Drejta e Martesës dhe e Krijimit të Familjes
Liria e Mendimit, e Ndërgjegjes dhe e Besimit Fetar
Liria e Shprehjes dhe e Informimit
Liria e Mbledhjes dhe e Asocimit
Liria e Artit dhe e Shkencës
E Drejta e Arsimit
Liria e Profesionit dhe e Drejta e Punës
Liria e Bisnesit
E Drejta e Pronës
E Drejta e Azilit
Mbrotjtja në rast Largimi, Dëbimi apo Ekstradimi

BARAZIA

Barazia Përballë Ligjit
Ndalimi i Diskriminimit
Respektimi i Shumëllojshmërisë Kulturore, Fetare & Gjuhësore
Barazia e Grave dhe e Burrave
Të Drejtat e Fëmijëve
Të Drejtat e të Moshuarve
Integrimi i Njerëzve Invalid

SOLIDARITETI

E Drejta e të punësuarve për informim dhe konsultim në kuadrin e kompanisë.
E Drejta e negociimit dhe e akteve kolektive
E Drejta e aksesit në shërbimet e gjetjes së punës.
Mbrotjtja në rastet e pushimeve të pajustificuara nga puna
Kushte të Drejta dhe të Përshtatshme Pune
Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mbrotjtja e punës së të rinjve
E Drejta e kombinimit të jetës familjare me atë profesionale
E Drejta e Sigurimit dhe e Asistencës Sociale
Mbrotjtja e Shëndetit

Aksesi në shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik
Mbrojtja e Ambientit
Mbrojtja e Konsumatorit

TË DREJTAT E QYTETARIT

E Drejta e votimit dhe për t'u votuar në zgjedhjet Europiane, në zgjedhjet Lokale dhe Komunitare
E Drejta e Mirëqeverisjes
E Drejta e aksesit të dokumentacionit zyrtar
E Drejta e apelit tek Ombudsman-i European
Liria e qarkullimi dhe e qëndrimit
Mbrojtja Diplomatike dhe Konsullore

DREJTËSIA

E Drejta e apelit real dhe e gjyqit të paanshëm.
Statusi i pafajësisë dhe e Drejta e mbrojtjes
Principet e ligjshmërisë & të analogjisë së veprave penale dhe ndëshkimit
E Drejta e individit që të mos gjykohet apo ndëshkohet penalisht dy herë për të njëjtën vepër penale.



Burimi: www.europarl.eu.int

Vlerat e B.E. të përballura me zhvillimet

B.E. po kalon një periudhë zhvillimesh dhe përballlet me sfida të shumta dhe të ndryshme si në skenën e brendshme ashtu edhe në atë ndërkombëtare.

Këto sfida vijnë nga shkaqe të ndryshme dhe kryesitë politike të shteteve anëtare të B.E. i kanë konsideruar terrorizmin, shtrirjen e armëve të zhdukjes në masë, konfliktet rajonale, krimin e organizuar dhe emigracionin klandestin si kërcënimet kryesore të jashtme të cilat ato thirren për t'i përballuar. Gjithashtu, edhe brenda Europës sfidat janë të shumta. Proçedura e ratifikimit të Traktatit Kushtetues European ka mbetur pezull, ritmi i zgjerimit të mëtejshëm shfaq tendenca ngadalësimi, dhe B.E. përpiqet të ekuilibrojë presionin e antagonizmit me kohezionin social.

Në çdo rast, sfidat por edhe politikat me të cilat ato përballohen, kanë të bëjnë dhe mund të influencojnë respektimin e të drejtave bazë të njeriut, të lirive politike dhe të të mirave bazë si gëzimi i drejtësisë dhe i sigurisë së banorëve dhe qytetarëve të B.E.

Shoqëria civile, duke përfaqësuar të gjitha grupet sociale dhe në të gjitha shtetet anëtare, ftohet gjithnjë e më shumë të shprehë vizionet e saj për Europën dhe të formulojë propozime për promovimin e vlerave Europiane si brenda ashtu dhe jashtë saj. Respektimi dhe promovimi i vlerave themelore bazohet në një nivel të konsiderueshëm në demokracinë pjesëmarrëse. Domethënë, në fund të fundit, ajo presupozon pjesëmarrjen, vigjilencën dhe iniciativën të gjithëve ne.



Burimi: www.europarl.eu.int

Adresa të rëndësishme:

<http://europa.eu.int>

<http://europa.eu.int/constituion>

<http://europa.eu.int/comm/echo/>

<http://www.europarl.eu.int/charter/>

<http://www.euro-ombudsman.eu.int/>

<http://echr.coe.int/convention/webconvGRE.pdf>

http://europa.eu.int/youth/your_rights/index_eu_el.html

www.synigoros.gr

www.eliamep.gr

Karta e të Drejtave Themelore:

[http://europa.eu.int/eur-](http://europa.eu.int/eur-lex/lex/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000X1218(01):EL:HTML)


[lex/lex/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000X1218\(01\):EL:HTML](http://europa.eu.int/eur-lex/lex/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000X1218(01):EL:HTML)

Për publikimet në lidhje me B.E. dhe serinë «*Europa në zhvillim*», drejtohuni në Përfaqësinë e Komisionit Europian (Vas. Sofias 2, tel. 210 72 72 100) dhe tek Zyrat e Parlamentit Europian (Bulev. Amalias 8, tel. 210 33 11 541)



Programme Action

Kjo broshurë u financua me mbështetjen e Komisionit Europian. Ky publikim obligon vetëm teksthartuesin dhe Komisioni Europian nuk mban përgjegjësi në rast të përdorimit të informacionit që përmban ky tekst. Broshura informuese është iniciativë e Fondacionit Grek për Politikën Europiane dhe të Jashtme (ELIAMEP) për informimin e qytetarëve Europian dhe banorëve të B.E.



ΕΛΙΑΜΕΠ

ΕΛΛΗΝΙΚΟ ΙΔΡΥΜΑ ΕΥΡΩΠΑΪΚΗΣ & ΕΞΩΤΕΡΙΚΗΣ ΠΟΛΙΤΙΚΗΣ
HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN & FOREIGN POLICY

ELIAMEP

ELIAMEP

Fondacioni Grek për Politikën Europiane dhe të Jashtme

Rr. Vas. Sofias 49, 10676 Athinë

Tel.: (+30) 210 72 57 110

email: eliamep@eliamep.gr